

Nr. 2 Prot.

VENDIM

Sot, më datë 26.04.2021, ora 11.00, administratori i shoqërisë "SkyLine Investments" shpk, Z. Ermal Kasa identifikuar me nr. personal J10312029E, thirri ortakët e shoqërisë dhe zhvilloi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në rrugë elektronike përmes videokonferencës, me rendin e ditës si vijon:

- Shkarkimin e administratorit në fuqi;
- Emërimin e administratorit të ri.

Ortakët e pranishëm në mbledhje janë:

1. Z. Ermal Kasa identifikuar me nr. personal J10312029E, zotërues i 50% (pesëdhjetë) të kapitalit të shoqërisë dhe;
2. Z. Halit Kasa identifikuar me nr. personal J20907014U, zotërues i 50% (pesedhjetë) të kapitalit të shoqërisë.

Pasi morën në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, ortakët e pranishëm konstatuan se këto çështje janë pjesë e kompetencave të tyre sipas përcaktimit në pikën 3 neni 81 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Në përfundim ortakët

VENDOSËN:

- Të miratojnë shkarkimin e administratorit Z. Ermal Kasa më datë 26.04.2021;
- Të emërojnë administratorin e ri Z. Halit Kasa identifikuar me nr. personal J20907014U për një periudhë 5-vjeçare (26.04.2021 – 25.04.2026);
- Të depozitojnë këtë dokument në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe brenda afateve ligjore;
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKU I SHOQËRISË

Ermal Kasa



ORTAKU I SHOQËRISË

Halit Kasa

